VENDIM
Nr. 46, datë 11.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari (Basha), në datën 31.1.2013, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 49/22 Akti, që i përket:

KËRKUES: Petraq Ilia

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Robert Ilia, Ilia Ilia

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit gjyqësor nr. 00-2011-2367(376), datë 20.9.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; i vendimit nr. 52, datë 6.3.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe i vendimit nr. 1550, datë 16.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 41, 42, 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenet 30, 45, 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, gjyqtarin Fatmir Hoxha; shqyrtoi pretendimet e kërkuesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, pretendimet e subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Subjektet e interesuara kanë paditur kërkuesin duke kërkuar njohjen si bashkëpronarë mbi dy objekte dhe një sipërfaqe trualli rreth tyre, të ndodhura në qytetin e Vlorës.

2. Pas shqyrtimit të çështjes prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2, datë 9.2.2006, kanë vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me tjetër trup gjykues.

3. Me vendimin nr. 1550, datë 16.7.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: Pranimin e kërkesëpadisë së subjekteve të interesuara/paditësit Robert dhe Ilia Ilia; Detyrimin e kërkuesit të njohë bashkëpronësinë mbi lokalin, mbi të gjitha shtesat e ndërtuara në të, si dhe mbi truallin prej 1100 m^2, me kufijtë përkatës; Detyrimin e kërkuesit të paguajë, duke filluar nga dita e ngritjes së padisë, gjysmën e të ardhurave mujore të fituara nga përdorimi i sendit në bashkëpronësi.

4. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 52, datë 6.3.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1550, datë 16.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-2367(376), datë 20.9.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 52, datë 6.3.2009 të Gjykatës

së Apelit Vlorë.

II

Pretendimet para Gjykatës Kushtetuese

6. ***Kërkuesi*** Petraq Ilia, në datën 13.4.2012 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2011-2367(376), datë 20.9.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; të vendimit nr. 52, datë 6.3.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr. 1550, datë 16.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kërkuesi pretendon se me vendimet e dhëna i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

6.1. Është shkelur parimi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore, sepse mungon baza ligjore. Gjykatat nuk kanë bërë analizën e provave dhe vendimet kanë kundërthënie të hapur dhe të fshehtë;

6.2. Është shkelur parimi i barazisë së armëve, pasi nuk u është dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe padia është pranuar mbi bazën e një prove të paligjshme, duke marrë si provë me dëshmitarë tej përmbajtjes së provës shkresore;

6.3. Është shkelur parimi i sigurisë juridike, pasi gjykatat me vendimet e tyre nuk kanë përcaktuar mënyrën se si subjektet e interesuara janë bërë pronarë. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë zbatuar konkluzionet e vendimeve njësuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke cenuar pritshmëritë e ligjshme.

7. ***Subjektet e interesuara, Robert dhe Ilia Ilia*** kanë parashtruar me shkrim si më poshtë:

7.1 Pretendimet e kërkuesit se vendimet janë të paarsyetuara, pasi u mungon baza ligjore, nuk është bërë analizë e plotë e provave, ka kundërthënie të hapur dhe të fshehtë në vendim, janë të pabazuara. Kërkuesi, me dashje, nuk përmend dispozitat ligjore të Kodit Civil dhe të Kodit të Procedurës Civile ku bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes. Gjykatat në vendime kanë arsyetuar duke analizuar të gjitha pretendimet e palëve, mbështetur në provat e paraqitura gjatë gjykimit. Gjithashtu, në arsyetimin e vendimeve nuk ka asnjë kundërthënie. Marrja dhe vlerësimi i provave është bërë në zbatim të neneve 232, 233 të Kodit të Procedurës Civile.

7.2 I pabazuar është dhe pretendimi se është cenuar parimi i barazisë së armëve. Pretendimet e kërkuesit janë të lidhura me kuptimin dhe interpretimin e ligjit në proceset gjyqësore, e, për rrjedhojë, nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

7.3 Gjykatat, gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjes, kanë zbatuar dhe interpretuar dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi dhe interpretimi nuk cenon parimin e sigurisë juridike, përkundrazi, përbën garanci për dhënien e drejtësisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

8. Në analizën e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata paraprakisht thekson se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që u ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese.

A. Lidhur me pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore

9. Kërkuesi pretendon se në vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mungon baza ligjore e padisë, nuk janë analizuar provat, si dhe ka kundërthënie të hapura dhe të fshehta.

10. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42, 142, pika 1 e Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion, të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin e arsyetimit të vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Neni 310, pika 1, i Kodit të Procedurës Civile parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve.

15. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se në vendimet objekt shqyrtimi janë pasqyruar palët ndërgjyqëse, baza e plotë ligjore, si dhe pretendimet e palëve. Rrjedha logjike e përdorur në vendim rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe argumentet e pjesës hyrëse janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Gjykata e Apelit Vlorë i ka cituar provat e administruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe i ka analizuar dhe vlerësuar ato. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka bërë një analizë të hollësishme të të gjitha pretendimeve të kërkuesit. Kolegji ka arritur në përfundimin se vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta janë të bazuara në ligj, duke vendosur lënien në fuqi të tyre.

16. Në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm kanë përmbajtje logjike brenda tyre dhe nuk paraqesin asnjë kundërthënie të hapur apo të fshehtë. Gjykatat janë të qarta në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe lidhur me faktet që janë konsideruar të provuara, duke zbatuar dhe detyrat e lëna nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në rigjykimin e çështjes.

17. Sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, është i pabazuar.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve

18. Kërkuesi pretendon se gjykatat në vendimet e tyre, nuk i kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të paraqitura lidhur me përcaktimin qartë të bazës ligjore dhe të mënyrës së fitimit të pronësisë nga subjektet e interesuara, duke cenuar parimin e barazisë së armëve. Gjithashtu, është marrë si e vlefshme një provë që ndalohet nga ligji, provë me dëshmitarë tej përmbajtjes së provës shkresore.

19. Gjykata ka tashmë një praktikë të konsoliduar, sipas së cilës parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që në çështjet civile secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në disavantazh ndaj kundërshtarit.

Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimin nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt, në kuptimin kushtetues. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë në kohë të mjaftueshme palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ata padrejtësisht nga gjykimi (*shih vendimin nr. 42, datë 29.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata konstaton se në çështjen në shqyrtim standardet kushtetuese lidhur me barazinë e armëve nuk janë cenuar nga gjykatat e zakonshme.

21. Në thelb, pretendimet e kërkuesit lidhen me interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e provave nga gjykatat e zakonshme, konkretisht me zbatimin e dispozitave të Kodit Civil për mënyrën e fitimit të pronësisë dhe vlerësimit të provave.

22. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë, pasi kanë shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura, midis tyre aktet shkresore që provonin bashkëpronësinë midis kërkuesit dhe subjekteve të interesuara, si dhe prova me dëshmitarë, i kanë vlerësuar të drejta pretendimet e subjekteve të interesuara. Gjykatat kanë arsyetuar dhe vlerësuar marrjen e provave me dëshmitarë në zbatim të neneve 232 dhe 233 të Kodit të Procedurës Civile[1].

23. Gjykata Kushtetuese ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve lidhet me interpretimin e zbatimin e ligjit, si dhe me vlerësimin e provave, e cila është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

25. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit nuk hyn në juridiksionin kushtetues e, si i tillë, nuk mund të merret në shqyrtim prej kësaj gjykate.

C. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

26. Kërkuesi pretendon se gjykatat, duke vendosur pranimin e padisë së paraqitur nga subjektet e interesuara, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi u kanë njohur të drejtën e pronësisë personave që nuk kanë qenë palë në veprime juridike. Mënyrat e fitimit të së drejtës së pronësisë, si një e drejtë themelore, janë të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë dhe në Kodin Civil.

27. Gjykata rithekson se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Jurisprudenca e kësaj Gjykate referon te ky parim konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar dhe të pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike është një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës dhe përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore (*shih vendimin nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në çështjen konkrete, objekt gjykimi ka qenë njohja e së drejtës së bashkëpronësisë në pasurinë lokal dhe truall. Subjektet e interesuara kanë pretenduar se kanë kontribuar bashkërisht në blerjen, ristrukturimin dhe ndërtimin e kësaj pasurie, pavarësisht faktit se në kontratën e blerjes është

---

[1] Neni 232 i Kodit të Procedurës Civile:
Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu, nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës ose shuarja, me anë të pagimit ose të faljes së detyrimeve në të holla, që rrjedhin nga një kontratë e bërë me dokument.
Neni 233 i Kodit të Procedurës Civile përcakton rastet e lejimit të provës me dëshmitarë.

shënuar vetëm emri i kërkuesit (njëri prej vëllezërve). Kontributet kanë ardhur dhe si rezultat i krijimit të shoqërisë "Ilia", në emër të së cilës është lëshuar dhe leja e ndërtimit për godinën. Qëllimi i subjekteve të interesuara dhe kërkuesit ka qenë krijimi i një pasurie të përbashkët. Në mungesë të një marrëveshjeje paraprake me shkrim mes tyre, ku do të shprehej qartë vullneti i vëllezërve, ata kanë rënë dakord që të shënohet vetëm emri i njërit prej tyre në kontratë. Ky moment ka përcaktuar natyrën e marrëdhënies juridike të krijuar mes tyre dhe natyrën juridike të mosmarrëveshjes së lindur më vonë. Ky proces konsiderohet njohje pronësie dhe është i detyrueshëm për palët e përfshira në gjykim.

29. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se qëndrimi i mbajtur nga gjykatat e zakonshme ka cenuar pritshmërinë e tij të ligjshme lidhur me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes gjyqësore. Sipas tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka pasur parasysh vendimet njësuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimet nr. 1, datë 6.1.2009 dhe nr. 9, datë 9.3.2006. Vendimet njësuese kanë mbajtur qëndrim për vlefshmërinë e veprimit juridik, kushtet për të qenë i tillë, formën dhe përputhjen e vullnetit, për cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve, për bazën juridike të padisë dhe shkakun ligjor të saj.

30. Gjykata çmon se dhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, dhe, si i tillë, edhe ky pretendim nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

31. Në përfundim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Petraq Ilia, për shfuqizimin e vendimeve objekt shqyrtimi, është e pabazuar dhe duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur më 19.3.2013

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi[2], Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

Anëtare kundër: Vitore Tusha

MENDIM PARALEL

Në çështjen konkrete pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, por e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim paralel, për të paraqitur arsye të ndryshme nga shumica për këtë qëndrim.

Shumica, në këtë çështje, për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka konstatuar se "në vendimet objekt shqyrtimi janë pasqyruar palët ndërgjyqëse, baza e plotë ligjore, si dhe pretendimet e palëve. Rrjedha logjike e përdorur në vendim rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe argumentet e pjesës hyrëse janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Gjykata e Apelit Vlorë i ka cituar provat e administruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe i ka analizuar dhe vlerësuar ato. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka bërë një analizë të hollësishme të të gjitha pretendimeve të kërkuesit" (*prg. 15 i vendimit*). Më tej, shumica ka vlerësuar se "vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm kanë

[2] Gjyqtari S. Berberi votoi pro rrëzimit të kërkesës, por me argumente të tjera.

përmbajtje logjike brenda tyre dhe nuk paraqesin asnjë kundërthënie të hapur apo të fshehtë. Gjykatat janë të qarta në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe lidhur me faktet që janë konsideruar të provuara..." (*prg. 16 i vendimit*). Si përfundim, shumica ka konkluduar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, është i pabazuar (*prg. 17 i vendimit*).

Gjykoj se, në vendimet e gjykatave objekt kontrolli, interpretimi dhe zbatimi i ligjit nuk ndjekin një rrjedhë logjike, të qartë dhe të kuptueshme. Por, këto të meta në arsyetim nuk janë aq serioze sa t'i bëjnë të cenueshme vendimet në fjalë, në aspektin kushtetues. Vlerësimi i tyre i përket juridiksionit të zakonshëm gjyqësor dhe, në shkallë të fundit, Gjykatës së Lartë.

Ashtu siç ka pohuar edhe shumica, Gjykata e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve ligjore të përcaktuara në jurisprudencën e saj, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Në aspektin e kontrollit kushtetues, nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Verifikimi që bën Gjykata në këto raste është një proces vlerësimi, nëpërmjet të cilit analizohet nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër. Ky vlerësim nuk bëhet vetëm në aspektin formal, pra nëse elementet e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë pasqyruar grafikisht në vendim, por edhe në aspektin substancial, se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë integruar këto elemente në drejtim të interpretimit të ligjit, analizës së provave dhe zgjidhjes së çështjes së themelit. Shumica, në rastin konkret, është mbështetur në një qasje formale dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit në aspektin substancial.

Në vendimet gjyqësore, objekt kontrolli, ekzistenca e marrëdhënies së bashkëpronësisë, të parashikuar nga neni 199 të Kodit Civil, i cili referohet si bazë ligjore, mbështetet në marrëveshjen verbale ndërmjet palëve, të cilën e kanë provuar nëpërmjet dëshmitarëve dhe dokumenteve të tjera, për shkak të marrëdhënieve të posaçme ndërmjet palëve, duke u bazuar në nenin 233 të Kodit të Procedurës Civile. Arsyetimi i gjykatave do të kishte një rrjedhë logjike nëse: fillimisht do të bëhej një cilësim i qartë i veprimit juridik/marrëdhënies juridike; do të sqarohej më pas se çfarë kërkon ligji për vlefshmërinë/provueshmërinë e kësaj marrëdhënieje juridike; dhe, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, do të interpretohej dhe vlerësohej në mënyrë të qartë neni 233 i KPC-së, kushtet që kërkohen për zbatimin e këtij neni dhe nëse këto kushte përmbusheshin në rastin konkret.

Siç u shpreha dhe më lart, të metat që konstatohen në interpretimin dhe zbatimin e ligjit material dhe procedural civil janë çështje të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor dhe, veçanërisht, të kontrollit rishikues të Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit, në disa raste të ngjashme, me bazë ligjore nenin 199 të Kodit Civil, e gjendur përpara marrëveshjes joshkresore të palëve për krijimin e bashkëpronësisë, ka theksuar rëndësinë e provës shkresore në marrëdhëniet e pronësisë dhe detyrimin e gjykatave për të argumentuar në vendim pamundësinë e palëve për marrjen e provës shkresore (*shih vendimin nr. 00-2007-1441, datë 5.11.2007 të Gjykatës së Lartë*). Edhe në vendimin nr. 00-2007-1583, datë 22.11.2007, Gjykata e Lartë është shprehur për fitimin e bashkëpronësisë sipas mënyrave që njeh ligji, duke nënvizuar detyrimin që kishte gjykata më e ulët për të evidentuar qartë në arsyetim se nuk përbën mënyrë të fitimit të pronësisë kontributi i një personi në shlyerjen e kredisë të marrë nga pronari i sendit.

Si përfundim, bazuar në sa më sipër, vlerësoj se të metat e evidentuara në arsyetimin e vendimeve, objekt shqyrtimi, nuk janë të tilla sa t'i bëjnë këto vendime të cenueshme, në aspektin kushtetues.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Ndaj mendim të kundërt me shumicën, pasi vlerësoj se vendimet, objekt shqyrtimi, kanë cenuar të drejtën themelore të kërkuesit për një gjykim të rregullt ligjor, në drejtim të *mosrespektimit të standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.*

Kërkuesi ka pretenduar se në vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mungon baza ligjore e padisë. Këtë pretendim shumica e ka analizuar nën dritën e së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42, 142, pika 1 e Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Standardi, të cilit i referohet edhe shumica, evidenton se "Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion, të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Ndryshe nga arsyetimi i shumicës, mendoj se standardet e mësipërme kushtetuese në lidhje me arsyetimin e vendimit gjyqësor, nuk gjejnë zbatim në çështjen konkrete objekt gjykimi, për arsye se edhe në rast se do të prezumonim se vendimi objekt shqyrtimi plotëson kërkesat për "pasqyrimin e palëve ndërgjyqëse, të bazës së plotë ligjore, si dhe të pretendimeve të palëve..." (paragrafi 15), evidentimi i këtyre elementeve formale nuk përbën argument të mjaftueshëm për të vlerësuar se baza ligjore e pasqyruar në vendim përbën bazën "mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes". Në rastin konkret, edhe pse vendimi i kundërshtuar pasqyron si bazë ligjore të mosmarrëveshjes nenin 199 të Kodit Civil, ky i fundit nuk parashikon asnjë nga mënyrat e fitimit të pronësisë apo të bashkëpronësisë, pasi neni në fjalë përcakton vetëm kuptimin e bashkëpronësisë. Edhe nenet 232 dhe 233, të cilave u referohet gjykata e zakonshme, janë norma procedurale që rregullojnë kufijtë e lejimit të provës me dëshmitarë. Në çështje, të cilat kanë për objekt shqyrtimi mënyrën e fitimit të pronësisë (apo bashkëpronësisë), faktet formohen sipas rregullave procedurale në varësi të kërkesave të ligjit material. Në rastin konkret, referimi nga gjykatat në rregullat procedurale të parashikuara nga nenet e mësipërme, nuk është e mjaftueshme për të provuar se kërkuesi gëzonte titullin e pronësisë, apo se e kishte fituar atë sipas një prej mënyrave të fitimit të pronësisë.

Nën dritën e vlerësimeve të mësipërme, mendoj se edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e sigurisë juridike, duhet parë në dritën e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Shumica, duke e renditur si pretendim më vete, arsyeton se: "pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, dhe, si i tillë, edhe ky pretendim nuk hyn në juridiksionin kushtetues". Ndonëse shumica e vlerëson pretendimin si çështje të interpretimit të ligjit apo zbatimit të tij, në fakt, vendimi gjyqësor i kundërshtuar nuk përmban asnjë analizë në lidhje me vlefshmërinë e kontratave, si akte noteriale të regjistruara në hipotekë, përmbajtja e të cilave mund të ndryshohet duke u goditur vetëm për falsitet, ose për ekzistencën e ndonjë prej rasteve të pavlefshmërisë. Në mungesë të analizës së këtyre fakteve, gjykata e zakonshme ka konkluduar në mënyrë të gabuar mbi ekzistencën e bashkëpronësisë, tej përmbajtjes së kontratave.

Në përfundim të analizës së mësipërme, nisur nga vlerësimi mbi bazueshmërinë e pretendimeve të kërkuesit, kërkesa duhet të ishte pranuar, me qëllim rivendosjen e të drejtave të cenuara.

Anëtare: Vitore Tusha